

V E N D I M

Nr. 22, datë 21.1.1999

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.43, DATË 17.1.1998 “PËR ORGANIZIMIN E PANAIREVE DHE TË EKSPOZITAVE TREGTARE”

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.43, datë 17.1.1998 bëhen këto ndryshime: 1. Pika 2 ndryshohet si vijon:

“Panairet dhe ekspozitat tregtare, me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar, të organizohen në bazë të një kalendarit vjetor, ku të përcaktohet lloji, koha dhe vendi ku do të zhvillohen.

Kalendari përgatitet nga Qendra Kombëtare e Panaireve dhe miratohet nga ministri i Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë.

Dhomat e tregtisë dhe të industrisë organizojnë panairë dhe ekspozita, kombëtare dhe ndërkombëtare, në bazë të kalendarit vjetor, të përgatitur nga Qendra Kombëtare e Panaireve.

Panairet vendore organizohen nën drejtimin e dhomave përkatëse të tregtisë dhe të industrisë, me mbështetjen e organeve të pushtetit vendor.”.

2. Pika 3 ndryshon si vijon:

“Shoqëritë, që merren me organizimin e panaireve dhe të ekspozitave tregtare, kombëtare dhe ndërkombëtare, duhet të plotësojnë kriteret për aftësitë teknike, profesionale dhe garancitë financiare, të përcaktuara në rregulloren e Qendrës Kombëtare të Panaireve.”.

3. Pika 7 ndryshon si vijon:

“Ngarkohet Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë për zbatimin e këtij vendimi.”.

4. Në vendim, fjalët “Ministria e Tregtisë dhe Turizmit” ndryshohen dhe zëvendësohen me fjalët “Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
Pandeli Majko**